



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 360/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS), dega në Graçanicë, paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit (KVV) në Leposaviq, për shkak të manipulimit të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 16.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e parashtruar nga subjekti politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS) dega Graçanicë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 14.06.2014, nga subjekti politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS), dega në Graçanicë, në të cilën theksohet se nga raporti i KQZ-së lidhur me publikimin e rezultatet preliminare, si dhe duke pasur qasje në rezultatet zgjedhore të publikuara për vendvotimin 1201B/04D për komunën e Leposaviqit konstatohet se në librin e votuesve për këtë vendvotim kanë votuar gjithsej 5 votues, ndërsa në kutinë e votimit janë evidentuar 264 fletëvotime nga të cilat 258 janë të vlefshme dhe 12 të pavlefshme. Parashtruesi i ankesës thekson se vetë shumica e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme e jep një shifër e cila tejkalon numrin total të fletëvotimeve të cilat gjendeshin në kutinë e votimit veprime këto që tregojnë qartë se është tentuar manipulimi me qëllim të rritjes së numrit të votave për një subjekt politik duke i dëmtuar subjektet e tjera politike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës kërkon që të rishqyrtohen dhe të anulohet procesi zgjedhor në të gjitha vendvotimet në komunën e Leposaviqit me qëllim të konstatimit të shkeljeve dhe keqpërdorimeve të bëra.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hedh poshtë (si të palejuara, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 360/2014 më datën 16.06.2014

Kryesuesi i Panelit

Hasan Shala



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.